



orët e malit

**orët e malit
2024**

Tirana Feminist Riso Lab

■■ HEINRICH BÖLL STIFTUNG
TIRANA
Albania

Pasqyra e Lëndës

Rea Nepravishta	fq. 3-6
Anxhela Pipero	fq. 7-8
Egi Pipero	fq. 9-12
Erald Nezaj	fq.13-14
Erisaida Veizaj	fq.15-16
Jozefina Vokrri	fq. 17-18
Kei Suçi	fq.19-20
Nje domate	fq. 21-22
Kriseida Omeri	fq. 23-24
Renid Tosuni	fq. 25-26
Tiziana Lohja	fq.27-28

Orët në Luginën e Valbonës

Në tregimet e njerëzve sot orët shpërfaqen të papërkthyeshme, jo thjesht si fjalë që nuk i gjehet e ngjashmja në një gjuhë tjetër, por edhe si qenie, sepse trajtat që ato marrin janë të shumëllojshme... herë janë të malit, pastaj futen tek brumbulli mbi dhe', lodrojnë pranë kroit gurgullues, orë të pyjeve, të shpellave, të stanit, me trajtat e cjamin që të pret shtegun në mal, ora - si vikatja e zogut kur gryka vetmon, hije femërore, gra - avuj të bardhë mbuluar me pëlhurë, flasin e pëshpërisin pas pemëve, jehona që përçojnë zërin nga maja në majë, një gjarpër vërtitet rreth djepit të foshnjes dhe e nuk e prek, gjarpëri del nga fundi i dheut dhe mban në vete brendinë e tokës mëmë.

Orët e mia

Në shoqërinë postmoderne, imazhi narçizist serialisht i riprodhueshëm na kthehet mbrapsht në pasqyrë si zhbërje e imazhit të vetvetes. Orët nuk janë dukja, ato janë të padukshme, ato i përkasin botës së mistershme, të paprekshme të Natyrës. Fjala është kthyer në mjet të egos, e përdorur që egoja të fitojë territor, e përherë më pak si përmasë e shpirtit për t'u shprehur me vërtetësi. Orët nuk flasin, në botën e tyre të përmëshur me shpirt, ato zgjedhin heshtjen.

Ndonjëherë i përfytyroj si gra të marra që duket se janë lëshuar nga kangjellat e një çmendine, sillen si të çartura, nuk ju afroresh dot, sepse të nëmin e të çmendin pa arsye. Nuk mund t'i parashikosh sjelljet e tyre. I kapërcejnë rregullat e këtij realiteti, i përvihen syrit të ngrirë të njeriut, jetojnë hijeve e hijeve shkojnë. Ato nuk i përthyhen asnjë përputhshmërie, asnjë linjë të vendosur, asnjë rregullësie paraprake. Janë gratë e përjashtimit, ato nuk i nënshtrohen fatit të paracaktuar, orët janë vetë fati.

Gra të cilat mallkimet nuk i lënë veç në fjalë që i merr era, por i kthejnë në veprim. A nuk do të ishte fantastike sikur ligësia të vërshonte një herë pa marrë leje, pa justifikime, pa lidhje shkakësore, pa vënie drejtësie, pa fre', por thjesht si ligësi e pastër dhe e plotë që manifestohet pa nevojë për shpjegim. A nuk do të ishte e mrekullueshme që këto orë të ishin disa copa dinamiti që shpërthenin kurdo e kudo e nuk përmbaheshin? Që dilnin papritur nga hijet e pëshjtjellonin gjithëkujt i afroreshin? Nuk ka asnjë logjikë që i përkufizon, që i kontrollon, orët thjesht janë, pavarësisht nga vullneti i njerëzve, ato shfaqen dhe bëjnë hatanë. Po, e përmbysin botën. Nuk është e mrekullueshme që disa gra pyjesh në formë gjarpërinjsh i kallin tmerrin njerëzve me forcën e tyre të mbinatyrshme, më saktë të nën-natyrshme, apo më saktë ë akoma, thjesht të natyrshme?

Natyra


Rea Nepravishhta

Natyra është një gjendje e palëvizshme ekstaze. Ajo është e plotë. E dendur, e gjallë, e mbushur me shpirt. Ajo na mbështjell me lëndën shpirtërore të gjithë ne. Në fakt Natyra nuk ka shpirt, ajo është shpirt. Homo sapiens zotëron, ndaj homo sapiens shkatërron. A ka ndonjë gjë që mund të posedohet vërtetë në përmasën tokësore ku banojmë? Vetë koncepti i të pasurit të diçkaje është farsë.

Pronar. Pronar i çfarë? Mund të bëhesh pronar i çdo milimetri mbi tokë, i çdo sendi material, pronar i çdo peme, i çdo gjetheje, i çdo dallge deti e rrëqeje përroi, pronar i të gjitha shtëpive të banuara nga orët në këtëbotë. Por je tepër i vogël, sidoqoftë, për të përvetësuar vijën e horizontit, tërthoren e qiellit, qindramijëra planete e yjësi atje lart, udhën e qumështit që netëve të errëta i bëhet udhërrëfyese brumbullit ndërsa çapitet ngadalë mbi dhe'.


Brumbulli - ai me siguri - duhet ta ketë për-vetë-suar gjithësinë.

Anxhela Pipero



7

8



11



12




13

Erald Nezaj



14



15

08 orë e malit, ndalu veg pak me tpa.



Erisaida Veizaj

16

Jozefina Vokrri

17



18



19

Kei Suçi



20



21

Nje domate

22




ORA
E FRYMËZIMIT
NUK MË
FLET.



"A NUK TË PËLQEN
ÇFARË SHEH
NË PASQYRË?"

MË PYET.

QËNDRON E HESHTUR
NË CËP TË DHOMËS.




TANI NUK I FLAS
UNË



25

26

Renid Tosuni



27



28

Tiziana Lohja